

gjuha e popullit si dhe me përsosjen e saj në shumë drejtime e bën më të lehtë realizimin e kësaj detyre.

Njohja me leksikun dhe frazeologjinë e krahinës nga ana e arsimtarit ndihmon jo vetëm për pasurimin e gjuhës, po edhe për të luftuar shmangiet nga norma leksikore.

Ekspeditat do të vazhdojnë në krahina të tjera me forca më të gjera në

të ardhmen.

Materialet e mbledhura po përpunohen dhe shkencorizohen për t'u futur në Kartotekën e leksikut të shqipes e për t'u shërbyer kështu studimeve të mëtejshme në fushën e gjuhës së sotme shqipe e të historisë së saj.

S. Gj.

Th. F.

### KRIJOHEN SEKTORË TË RINJ NË INSTITUTIN E GJUHËSISË E TË LETËRSISË

Kohët e fundit, pranë Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë u ngrit sektori i teorisë së letërsisë. Detyrat e këtij sektori janë të rëndësishme dhe të gjera. Në radhë të parë punonjësit e sektorit të teorisë së letërsisë do të merren me studimin e problemeve teorike me rëndësi të madhe për zhvillimin e letërsisë së sotme, siç është problemi i rolit të botëkuptimit në krijimtarinë letrare, i marrëdhënies midis botëkuptimit dhe metodës artistike, problemi i rolit të idealit në krijimtarinë letrare, i ligjsorive të procesit historiko-letrar etj. Krahas përpunimit të këtyre problemeve me karakter të përgjithshëm teorik, sektori do të merret edhe me studimin e problemeve teorike të realizmit socialist, të cilat kanë rëndësi të madhe sepse lidhen drejtpërdrejtë me procesin e zhvillimit të letërsisë sonë të sotme.

Probleme të rëndësishme me të cilat do të mirren punonjësit e këtij sektori janë edhe problemet e poetikës si edhe të stilistikës e të prozadisë, të cilat përbëjnë një fushë të gjerë kërkimesh me karakter teorik dhe historik.

Vëmendje do t'i kushtohet njohjes dhe aplikimit të metodave të reja, të cilat siç dihet kanë ngjallë interesimin e shumë studjuesve për rezultatet e arritura sidomos në lëmin e prozadisë e në veçanti të metrikës.

Siç shihet, sektori ka përpara një

fushë të gjerë studimesh; për këtë qëllim ai do të bashkojë forca të jashtme dhe pedagogë të teorisë së letërsisë, të estetikës etj.

Me qëllim për të zhvilluar studimet e letërsisë shqiptare për fëmijë pranë Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë u ngrit edhe një sektor tjetër, sektori i letërsisë për fëmijë.

Krijimi i këtij sektori vjen të plotësojë një nevojë që ndihesh prej kohësh; siç dihet, krijimtaria letrare për fëmijë ende nuk është bërë objekt studimesh me monografi dhe punime monografike shkencore. Sektori do të organizojë studimin mbi baza shkencore të historisë së letërsisë shqiptare për fëmijë në përgjithësi, të periudhave e problemeve që dalin në periudha të ndryshme, do të studjojë krijimtarinë e autorëve të shquar në këtë fushë etj.

Sigurisht objekti kryesor i studimit për punonjësit e këtij sektori është krijimtaria letraro-artistike bashkëkohëse, letërsia për fëmijë që zhvillohet në rrugën e realizmit socialist. Sektori do të studjojë gjithashtu probleme të ndryshme teorike mbi specifikën e letërsisë për fëmijë, mbi gjinitë etj. Studimet historiko-letrare, monografite do të përbëjnë një bazë të rëndësishme për hartimin e veprës shkencore «Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë», ku do të përgjithësohet rruga e zhvillimit historik të letërsisë shqiptare për fëmi-

